



Datë: 06.08.2025
Numër Protokolli: 5366/2025

A.nr.1086/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1086/2025, të datës 05.06.2025, të parashtruar nga ankuesja E.Sh, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e papabazuar ankesa me numër A.nr.1086/2025, e datës 05.06.2025, e parashtruar nga ankuesja E.Sh.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me Nr.01-112/01-0037836/2025 i datës 30.05.2025, për shpalljen e rezultatit përfundimtar për konkursin me numër Reference RN00017287 për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale*, i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, E.Sh (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), me datë 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër Reference RN00017287 për Grupin e Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale, gjegjësisht për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale, i shpallur me datë 21.03.2025 nga Komuna e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa kjo e fundit me datë 01.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit pas pranimi të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 4831/2025, të datës 18.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1086/2025 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3801/2025 të datës 05.06.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00017287 të datës 21.03.2025; Dokument identifikimi i ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 01.07.2025; Listën e kandidatëve; Njoftimin e datës 23.04.2025; Vendimin me Nr.prot.01-112/01-0028632/25 të datës 28.04.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimi, si dhe Akt emërimit e tyre; Kërkesën për shpallje me numër reference 060-25/ZKD të datës 21.03.2025; Eset dhe formularët e vlerësimit të esesë të datës 15.05.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisioni për kandidatin në intervistë të datës 20.05.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Aplikacionin e kandidatës E.B të datës 08.04.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Aplikacionin e ankueses të datës 17.04.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Komuna e Pejës, më datë 21.03.2025 ka shpallur Konkursin me Numër Reference: RN00017287 për Grupin e Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale, gjegjësisht për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale, klasa profesional 2, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar shtatëmbëdhjetë (17) kandidatë, ku prej tyre sipas Njoftimit me Nr.01-112/01-0027807/25 të datës 23.04.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës, rezulton se vetëm pesë (5) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja janë përfshirë në listën e ngushtë si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e rekrutimit, duke arritur gjithsejtë 82.8 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 30.05.2025, ka publikuar njoftimin me Nr.01-112/01-0037836/2025 për rezultatet përfundimtare, nga i cili njoftim rrjedhë se nga kjo procedurë rekrutimi janë katër (4) kandidatë fitues të cilët kanë arritur pragun e kalueshmërisë mbi 70 pikë, mirëpo si kandidate fituese me më së shumti pikë të arritura është kandidatja E.B, e cila me gjithsejtë 89.6 pikë të arritura, është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës Zyrtar për Shërbime Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Pejës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se kandidatja fituese është mbivlerësuar dhe se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin arsimor, duke theksuar po ashtu se e njëjta në raport me cv-në e saj duhet të reflektonte në nivel më të lartë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së kësaj pozite, respektivisht sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017287 për Grupin e Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale, gjegjësisht për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale, klasa profesional 2, dhe ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor): Psikologji/Sociologji Punë Sociale, Logopedi. **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një)

vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, e për rrjedhojë Kolegji vlerëson se konkursi është shpallur sipas kriterëve për grupin e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Rrjedhimisht, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht Nenin 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj*”, dhe nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.*

Po ashtu Kolegji ju referua, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, respektivisht nenit 6 paragrafi 2 të, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Ndërsa, sipas nën pikës 2, 3 dhe 5 të pikës 5 të konkursit të datës 21.03.2025, rezulton se dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, janë përcaktuar si në vijim: *2. Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë. 3. Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jaashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.... 5. Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Andaj, referuar dispozitave të lartë theksuara ligjore, kërkesave të përgjithshme formale si dhe dokumenteve që duhet dorëzuar me rastin e aplikimit në konkursin përkatës, Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses se kandidatja fituese nuk plotëson kriterin arsimor, ka analizuar aplikacionin e datës 08.04.2025 të kandidates E.B, nga rezulton se e njëjta sa i përket plotësimit të kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.2303/22 të lëshuar

me datë 03.08.2022 nga Kolegji “AAB”, me të cilin dokument dëshmohej se e njëjta me datë 06.07.2022 ka mbaruar studimet në Programin Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve duke fituar kështu titullin Bachelor i Arteve në Përkujdesje dhe Mirëqenie të Fëmijëve, rrjedhimisht, bazuar në të gjeturat si më sipër si dhe referuar Ueb faqes së Kolegjit AAB, konkretisht ndarjeve të Fakulteteve, rezulton se fusha e studimeve të ankueses hynë në Shkencat Sociale, ndërsa po ashtu Qëllimi dhe Profili i Programit përkatës ka ngjashmëri dhe përputhet me përshkrimin e përgjithshëm të punës Zyrtar për Shërbime Sociale. Lidhur me plotësimin e përvojës së punës profesionale pas diplomimit kandidatja në fjalë, ka bashkangjitur Kontratë e Punësimit me Afat (Kohë) të Caktuar të datës 01.06.2021, përmes së cilës theksohet se e njëjta ka qenë e angazhuar tek punëdhënësi i sektorit privat “Verbatim” në cilësinë e Menaxheres së Shitjes, dhe atë nga data 01.06.2021 deri më 31.08.2024, dhe se për këtë përvojë pune e njëjta ka bashkangjitur edhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, nga i cili rezulton se kandidatja në fjalë ka 15 muaj kontribute të paguara pas diplomimit nga ky punëdhënësi i sektorit privat. Rrjedhimisht, mbi bazën e këtyre të gjeturave Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses se kandidatja E.B nuk ka plotësuar kriterin arsimor është i pa qëndrueshëm, ngase fushat e studimeve bachelor dhe master në Kolegjet dhe Universitetet jo-publike apo private në Republikën e Kosovës të akredituara dhe licencuara nga institucionet dhe ligjet përkatëse kanë emërtime të ndryshme për dallim nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës, dhe se bazuar në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *1. Pranimit në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese.*; rrjedhimisht, Kolegji thekson se programi i studimeve të përfunduara apo emri i titullit të fituar nëse përshtatshëmrisht fusha e studimeve është e njëjtë, nuk duhet të ndikojë në atë mënyrë që kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet pranë këtyre institucioneve jo-publike të arsimit të lartë të diskriminohen dhe të humbin të drejtën punësimit në institucionet publike.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë se ankuesja dhe kandidatja E.B, kanë arritur pikët e mjaftueshme për kalueshmërinë e testit me shkrim prej 50 pikëve, ashtu siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, përkatësisht ankuesja ka arritur 57 pikë ndërsa kundër kandidatja 62.8 pikë nga faza e testit me shkrim, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses i ’u referua nenit 10, të kësaj rregulloreje ku përcaktohet se: *1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit*

bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve; dhe se nga analizimi i formularëve të vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatin në intervistën e datës 20.05.2025, rezulton se ankuesja sikurse edhe kandidatja E.B tek fusha e arsimimit dhe përvojës së punës janë vlerësuar me pikë maksimale nga Komisioni i Pranimit, respektivisht me nga 3 dhe 4 pikë për secilën fushë përkatëse, ngase të njëjtat kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të lartë theksuara, ndërsa për dallim nga kundër kandidatja e cila nga të gjithë anëtarët e Komisionit tek kjo fushë është vlerësuar me nga 1 pikë, ankuesja rezulton se tek fusha e trajnimeve relevante rezulton se është vlerësuar me nga 3 pikë maksimale, andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Pranimit në këtë rast nuk ka mbi vlerësuar kandidaten E.B, por ka vepruar në pajtim me dispozitat e sapo theksuara ligjore dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ashtu që mbi këtë bazë pretendimi ankimor se vlerësimi i përgjigjeve të ofruara në intervistë duke marrë parasysh cv-në e saj apo përvojën relevante, kualifikimet dhe aftësitë administrative duhej të reflektonte një nivel më lartë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore, ngase vlerësimi i përgjigjeve të ofruara nga kandidatët në intervistë sipas legjislacionit në fuqi për procedurat e pranimit në shërbimin civil është në diskrecion të Komisionit të Pranimit.

Andaj, bazuar në konstatimet e më sipërme se pretendimet ankimore të ankuses janë të pabazuara ligjërisht, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja E.B, ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, të përcaktuara me shpalljen e konkursit me numër Reference RN00017287, për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale* në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Pejës, dhe duke qenë se e njëjta ka kaluar me sukses testin me shkrim me gjithsejtë 62.8 pikë dhe intervistën me gojë me gjithsejtë 26.8 pikë dhe ka mbledhur kështu gjithsejtë 89.6 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, si rrjedhojë e njëjta ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi me Nr.01-112/01-0037836/2025 i datës 30.05.2025, për shpalljen e rezultatit përfundimtar për konkursin me numër Reference RN00017287 për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Sociale*, në Komunën e Pejës, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1086/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.Sh;
- Kryetarit të Komunës dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.